

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“VNM e thelluar për projektin “Ndërtimi i linjës së re 220 kV dopjo qark Fier – Hoxharë me përcjelles ACSR 490/65, si dhe ndërtimi i nënstacionit të ri 220/110/20 kV Hoxharë, bashkë me dy dalje linje 220 kV” dhe zhvillimi i takimit informues paraprak të komunitetit mbi zbatimin e projektit”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

71313400-9 - Vleresim i impaktit qe ka dertimi ne mjedis

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

1,159,000 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit te Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

*2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, të paktën 450,000 (katerqind e pesedhjetë mijë) Leke.*

*Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

*Si prove për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë vertetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për vitet e sipërpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë shërbimin objekt procedure prokurimi dhe shtrirjen gjeografike territoriale ku do të realizohet kontrata, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros të jetë në masën 450,000 (katerqind e pesedhjetë mijë) Lekë.

---

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

*2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme në një vlerë të pakten prej 200,000 (dyqind mijë) Lekë pa TVSH.*

*Lidhur me këtë pikë:*

*Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kërkohej vërtetimi të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë shërbimet objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

---

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i certifikuar, në përputhje me Ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, në një nga mënyrat si më poshtë:*

*a) në rastin e personit fizik, certifikuar si ekspert nga ministri;*

*b) në rastin e personit juridik, administratori i të cilit duhet të jetë i certifikuar si ekspert nga ministri dhe të ketë të punësuar me kontratë pune të paktën edhe 1 ekspert të certifikuar nga ministri;*

**Argumentimi:** Subjektet e përcaktuara, personi fizik/juridik, duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie hartimin e raporteve të VNM-së, kjo jep siguri për ne si Autoritet Kontraktor që shërbimi i kërkuar do të kryhet me sukses. Subjektet që hartojnë raportin e VNM-së krijojnë grup specialistësh të kualifikuar, sipas fushave përkatëse që trajton raportin e VNM-së. Raporti i VNM-së nënshkruhet nga personi fizik/juridik dhe specialistët e përfshirë në hartimin e raportit të VNM-së. Ky kriter është bazuar në nenin 44, pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues (person fizik apo juridik), hartues i raportit dhe ndjekës i procedurës, duhet të jetë i licencuar nga QKB-ja, sipas kategorisë III.2.A, në përputhje të Ligjit Nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për të përmbushur këtë pikë, OE duhet të paraqesë licencën përkatëse.*

**Argumentimi:** Operatori ekonomik, personi fizik/juridik, hartojnë raportin e VNM-së se thelluar duke krijuar grup specialistësh të kualifikuar, sipas fushave përkatëse që trajton raportin e VNM-së (në këtë rast në fushën e energjisë) sipas Nenit 24 të Ligjit nr.10440, datë 07.07.2011 “Për

vlerësimin e ndikimit në mjedis” te ndryshuar Ky kriter është bazuar ne nenin 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues, hartues i raporteve dhe ndjekës i procedurave, duhet të ketë eksperiencë në hartimin e raporteve të Vlerësimit të Ndikimit të Mjedis për projektet në fushën e industrisë së energjisë. Per te permbushur kete pike, OE duhet te paraqese dokumentacione te ndryshme si: trajnime, eksperiencia pune, CV te kopmanise apo te punonjesve, vërtetime nga kompani te ndryshme energjetike, libreze pune, listë pagesën e fundit e-sig.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin si prove paraprake formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është e bazuar ne VKM Nr. 686, Datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit Të Ndikimit Në Mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” I ndryshuar. Ky kriter është bazuar ne nenin 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues, hartues i raporteve dhe ndjekës i procedurave për aplikim duhet te jete i pajisur me firme elektronike për te nënshkruar te gjitha raportet e hartuara për procedurën e VNM se thelluar. Raporti mbi “Informacion për ndërveprimin me mjedisin të projektit”, Raportin Teknik si dhe Raportin e VNM së thelluar duhet të jenë te nënshkruar në mënyrë elektronike nga OE. Per kete, duhet te paraqese deshmine perkatese te vlefshme.*

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është e bazuar në Nenit 16 të Ligjit Nr.12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” te ndryshuar dhe VKM nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore” te ndryshuar. Ky kriter është bazuar ne nenin 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues, duhet te paraqese nje deklarate ku te specifikojte se: do te hartojte dokumentacionet dhe do te ndjekë te gjithë procedurat për aplikim, do te ndjeke te gjitha procedurat për informimin e publikut gjate VNM-se, duke zhvilluar takime me komunitetin, do te informoje dhe konsultohet me publikun e interesuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis të veprimtarisë së tij.*

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është e bazuar në Nenit 16 të Ligjit Nr.12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” te ndryshuar dhe VKM nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për

informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore” te ndryshuar.. Ky kriter eshte bazuar ne nenin 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*2.3.7 Ne funksion te plotesimit te Shtojces 9 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.*